



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Bordi

VENDIM

Nr. 101, Datë 30.04.2018

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR MIRATIMIN E KODIT TË RRJETIT PËR
NGARKESËN**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 23, gërma “b” të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; nenit 26 të “Rregullores për Organizimin, Funkcionimin dhe Procedurat e ERE”, miratuar me Vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016” si dhe parashikimeve të vendimit nr. 2018/05/PHLG-EnC, datë 12.01.2018 të Grupit të Përhershëm të Nivelit të Lartë të Komunitetit të Energjisë, bordi i ERE në mbledhjen e tij të datës 30.04.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoritë Teknike, mbi fillimin e procedurës për miratimin e Kodit të rrjeti për ngarkesën,

Dhe pasi mori në konsideratë:

- Se Shqipëria është anëtare e Komunitetit të Energjisë që nga data 01.07.2006;
- Rregulloren e (BE) nr. 714/2009, të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit Evropës;
- Kërkesat e Rregullores së Komisionit (KE) 2016/1388 datës 17 Gusht 2016 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit Evropës;
- Vendimit nr. 2018/05/PHLG-EnC, datë 12.01.2018 të Grupit të Përhershëm të Nivelit të Lartë të Komunitetit të Energjisë;
- Parashikimet e Ligjit nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”;
- Certifikimin operatorit të sistemit të transmetimit të energjisë elektrike OST sh.a;
- Operatori i sistemit të transmetimit të energjisë elektrike OST sh.a është anëtare me të drejta të plota e ENTSO-E;
- Sipas Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, ky Kod propozohet për miratim në ERE nga OST sh.a dhe duhet të transpozohet pa ndryshuar tekstin apo strukturën e tij. Dispozitat e këtij Kodi do të prevalojnë ndaj Kodit të Transmetimit miratuar me vendimin nr. 186, datë 10.11.2017, të Bordit të ERE dhe çdo akti tjetër rregullator i sektorit të energjisë.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për miratimin e Kodit të rrjeti për ngarkesën.
2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë të interesuarit për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI

https://ere.gov.al/doc/Kodi_i_Matjes_Vendim_nr.101,_date_26.8.2008.pdf